



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
SEKTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN

3096  
Nr. \_\_\_\_\_ prot

Roskovec, më 23.04.2026

PROJEKT-VENDIM

NR \_\_\_\_\_, DATË 23.04.2026

PËR

ANËTARËSIMIN E BASHKISË ROSKOVEC NË SHOQATËN E QYTETEVE DHE  
RAJONEVE PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË BURIMEVE  
(ASSOCIATION OF CITIES AND REGIONS FOR SUSTAINABLE RESOURCE  
MANAGEMENT / ACR+)

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.5 dhe 1.6, nenit 23, nenit 54, shkronja “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 10 të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore” të Ligjit nr. 9936/2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’ të ndryshuar, Vendim Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.71 datë 24.12.2025, “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026 dhe miratuar nga Prefektura e Qarkut Fier me shkresë Nr 139/1 prot, datë 06.01.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:**

1-Të miratojë anëtarësimin e Bashkisë Roskovec në “Shoqatën e qyteteve dhe rajoneve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve” Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management (ACR+) duke i dhënë mundësinë të jetë pjesëmarrëse në projekte dhe programe ndërkombëtare në një rrjet që promovon menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe bashkëpunimin ndërmjet qyteteve dhe rajoneve.

2- Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për nënshkrimin e formularit të anëtarësimit në “Shoqatën e qyteteve dhe rajoneve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve” Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management (ACR+).

3-Miratimin e pagesës së kuotës së anëtarësimit përfshirë dhe komisionin bankar në vlerën **78,000 lekë (shtatëqind e tetëdhjetë mijë lekë)** e cila do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec i miratuar me Vendim Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.71 datë 24.12.2025, “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026 dhe miratuar nga Prefektura e Qarkut Fier me shkresë Nr 139/1 prot, datë 06.01.2026.

4-Ngarkohet për zbatim pas miratimit të këtij projekt-vendimi, Sektori i Integritimit European, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë.

Konceptoi: *U.Blido*

Pranoi: *N.Pelivani*

Për Drejtorinë Juridike: *V.Zeqo*

**KRYETAR**  
**Majlinda Bufi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
SEKTORI I INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 3096/1 prot

Roskovec, më 28. 04. 2026

Lënda: Relacion për projektvendimin “Për anëtarësimin e Bashkisë Roskovec në Shoqatën e Qyteteve dhe Rajoneve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve (Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management / ACR+)”

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**Roskovec**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.5 dhe 1.6, nenit 23, nenit 54, shkronja “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 10 të ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore” të Ligjit nr. 9936/2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Vendim Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.71 datë 24.12.2025, “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026 dhe miratuar nga Prefektura e Qarkut Fier me shkresë Nr 139/1 prot, datë 06.01.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

Projekt-vendimi që ju paraqesim për miratim ka si objekt anëtarësimin e Bashkisë Roskovec në “Shoqatën e Qyteteve dhe Rajoneve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ACR+” (Association of Cities and Regions for Sustainable Resource Management )

Shoqata e qyteteve dhe rajoneve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve është një rrjet ndërkombëtar qytetesh dhe rajonesh që ndajnë një qëllim të përbashkët: promovimin e praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve. E themeluar për të inkurajuar inovacionin, transferimin e njohurive dhe bashkëpunimin të lëvizjes drejt një ekonomie rrethore, ku burimet përdoren në mënyrë të qëndrueshme dhe mbeturinat minimizohen, ku autoritetet nënkombëtare luajnë një rol kyç dhe krijojnë bashkëpunime të forta me një mori palësh të interesuara të ndryshme

**2-Qëllimi kryesor i ACR+**

- Promovimi i ekonomisë qarkulkuese (riciklim, ripërdorim, reduktim mbetjesh)
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore
- Mbrojtja e mjedisit dhe klimës
- Mbështetja e politikave lokale të qëndrueshme

### 3-Anëtarësimi në këtë organizatë do t'i mundësojë Bashkisë Roskovec:

- Rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm
- Shkëmbimin e praktikave më të mira në menaxhimin e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit
- Pjesëmarrjen në projekte dhe programe ndërkombëtare
- Përfitim nga trajnime dhe asistencë teknike për rritjen e kapaciteteve institucionale
- Rritje e kapaciteteve të stafit (trajnime & ekspertizë)
- Mbështetje për menaxhimin e mbetjeve, projekte mjedisore, energji të rinovueshme
- Mundësi për partneritete me bashki të tjera europiane

4-Anëtarët e këtij rrjeti përfitojnë nga qasja në praktikën, mjetet dhe ekspertizën më të mirë, që synojnë të ndihmojnë autoritetet lokale dhe rajonale të zbatojnë strategji të përparura të menaxhimit të mbeturinave dhe rikuperimit të burimeve. Përmes partneriteteve, trajnimit dhe avokimit të politikave, ACR+ luan një rol kyç në nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve në Evropë dhe më gjerë.

5- Kostoja e anëtarësimit përfshirë dhe komisionin bankar në vlerën **78,000 lekë (shtatëqind e tetëdhjetë mijë lekë)** e cila do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec i miratuar me Vendim Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.71 datë 24.12.2025, "Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026 dhe miratuar nga Prefektura e Qarkut Fier me shkresë Nr 139/1 prot, datë 06.01.2026.

6-Bashkia Roskovec ka tashmë eksperiencë bashkëpunimi me disa organizata ndërkombëtare, të cilat operojnë në fushën e demokracisë vendore dhe qeverisjes së mirë. Në këtë kontekst, anëtarësimi në ACR+ përbën një hap të mëtejshëm drejt zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke e plotësuar këtë eksperiencë në një tjetër dimension të rëndësishëm, atë të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe mbrojtjes së mjedisit.

Për sa më sipër shpresojmë në mirëkuptimin tuaj për miratimin e këtij projekt-vendimi.

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj!*

Konceptoi: *U. Blido*

Pranoi: *N. Pelivani*

*Sasia e ekzemplarëve të shtypur 3 (tre) !*

**KRYETAR**  
**Majlinda Bufi**